

**MEMORIALET DHE PËRMENDORET NË KOMUNËN E MALISHEVËS NGA VITI
1999 DERI NË VITIN 2020**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER HISTORI E KOHËS SË RE**

NGA

LAURA ZOGAJ



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

QERSHOR, 2022

EKspoZE E TEMËS

MEMORIALET DHE PËRMENDORET NË KOMUNËN E MALISHEVËS NGA VITI 1999 DERI NË VITIN 2020

Mentor:

Prof.Asoc.Dr.Selim Bezeraj

Kandidatja:

Laura Zogaj

Ky punim ka për objekt studimi memorialet dhe përmendoret në Komunën e Malishevës, ku me anë të këtij punimi hulumtues, shohim që komunën e Malishevës e karakterizojnë një numër i memorialeve dhe përmendoreve pastaj buste të ngritura si shenjë e sakrificës që bënë dëshmorët dhe martirët të rënë për lirinë e vendit. Studimi për memorialet dhe përmendoret është tejet i rëndësishëm, sepse me anën e tyre shihet dhe pasqyrohet një pamje dhe gjendje reale e tyre. Rëndësia e këtij punimi pra është të identifikojm se cilat janë ato, cilat janë ndërtuar dhe restauruar nga viti 1999 deri në vitin 2020 që kanë për synim mbikqyrjen dhe menaxhimin e tyre, pra roli i tyre historik ku kemi po thuajse në çdo fshat memoriale, pllaka përkujtimore, buste të ngritura të dëshmorëve, martirëve të cilë flijuan jetën e tyre . Duke u nisur nga rëndësia e studimeve që kanë memorialet në punim do të bëhet përpjekje për një studim të thelluar të veçorive themelore të memorialeve, mbështetur mbi të dhëna hulumtuese dhe asaj eksperimentale. Punimi përqendrohet, në një analizë të thelluar hulumtuese duke vënë në dukje memorialet dhe përmendoret. Qëllimi ynë është gjithmonë që, përmes këtij studimi të thelluar të krijohen hapësira të reja, që presin për t'u mbushur më tej, prej nesh ose prej të gjithë atyre, që kërkojnë të merren me memorialet dhe përmendoret në komunën e Malishevës.

Vëmendje e vogël i është kushtuar çështjes së memorialeve në Kosovë që nga lufta e viteve 1998-99. Prandaj, ka mungesë të literaturës në këtë temë. Rrjedhimisht, ky raport nuk mbështetet vetëm në analizimin e literaturës por jep të dhëna të mëtejshme të mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar. Është e rëndësishme që ta kemi parasysh që memorializimi në relacion me drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë, mbetet një fushë e studimit shumë e re dhe e pashkelur. Megjithatë ka pyetje të rëndësishme që ne mund të

fillojmë t'i adresojmë dhe ky punim ka për qëllim të ndihmojë në vënien e themeleve për diskutim të mëtejshëm dhe praktika të ardhshme mbi çështjen e memorializimit në Kosovë.

Qëllimi i këtij punimi hulumtimi nuk është që të jepen vlerësime të natyrës presikiptive, as të mbahet qëndrim lidhur me rastet e hulumtuara, por që përmes korpusit të zgjedhur, të pasqyrohet një gjendje faktike e memorialeve dhe përmendoreve në komunën e Malishevës. Për studimin e literaturës jemi mbështetur në mbledhjen e materialeve dhe të autorëve të cilët janë marrë kryesisht me studime të kësaj fushe. Për këtë jemi përpjekur të studiojmë edhe literaturën e autorëve të ndryshëm.

Metodat që do të përdorim në trajtimin e çështjes sonë do t'i kemi të mbështetura në intervista, vëzhgim dhe interpretim. Do të përpiqemi të sjellim një pasqyrë më të qartë të memorialeve dhe përmendoreve në Malishevë. Për t'ia dalë mbanë kësaj gjëje do të përdorim metodën e hulumtimeve të materialeve teorike për aktet themelore që kanë shtjelluar ecurinë nga pikëpamja e kodifikimit si dhe një literaturë të gjerë në fushën e historisë, në fushën arkeologjike dhe socioale të përgjithshme dhe të veçantë për zonën që trajtojmë. Në kapitullin e parë trajtohen memorialet dhe përmendoret në komunën e Malishevës numri i tyre veçanërisht memorialet e dëshmorëve dhe martirëve kontributi dhe sakrificat e tyre për çlirimin e tokave shqiptare. Në kapitullin e dytë bëhet fjalë për memorialet tjera ku hynë bustet e dëshmorëve dhe përfshirjen e tyre në UÇK, pastaj pllakat përkujtimore. Në kapitullin e tretë bëhet fjale për mirëmbajtjen dhe restaurimin e memorialeve dhe përmendoreve se sa është kujdesi ndaj tyre. Duke mbledhur opinione të ndryshme dhe duke analizuar arrim të vlerësojmë rëndësinë që kanë për popullin shqiptar.